

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN E KESHILLIT TË MINISTRAVE**

**PËR
CILËSINË E DISA LËNDËVE TË DJEGËSHME, TË LËNGËTA, PËR
PËRDORIM TERMIK, CIVIL E INDUSTRIAL SI DHE PËRDORIM NË
MJETET E TRANSPORTIT UJOR**

**I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektvendim synon reduktimin e shkarkimeve të dioksidit të squfurit që vjen nga përdorimi i lëndëve djegëse të lëngëta të prodhuara nga hidrokarburet, në mënyrë që të zvogëlohen efektet e dëmshme tek njeriu dhe mjedisi.

Objektivi që synohet të arrihet, është kufizimi i përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta të prodhuara nga hidrokarburet, si kusht për përdorimin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, ujërat territoriale të Shqipërisë, zonat ekskluzive ekonomike dhe zonat e kontrollit të ndotjes.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE
DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi është hartuar në përputhje me objektivin e programit të Qeverisë Shqiptare, për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit duke garantuar mbrojtjes së mjedisit.

Hartimi i këtij projektvendimi është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian për vitin 2019, katërmujori III.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që përcakton “Traktati për krijimin e Komunitetit të Energjisë”, i ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, ”Për ratifikimin e Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë”, përfshihet edhe plotësimi i kërkesave të neneve 5, 12 dhe 16, si dhe pikave 2 e 3 të shtojës II, të ligjit nr. 9501, datë 3.4.2006, për implementimin në

legjislacionin shqiptar të *“acquis communautaire”* mbi mjedisin. Vendimi i Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë d/2016/15/MC-EnC, i datës 14 tetor 2016, “Mbi amendimin e Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë dhe miratimin dhe zbatimin e Direktivës (EU) 2016/802 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, dhe të Vendimit të Komisionit (EU) 2015/253”, ka ndryshuar përkatësisht nenin 16 (pika ii) të “Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë” dhe ka shtuar pikën (2a) në shtojcën II të tij, sipas të cilit: **Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë brenda datës 30 Qershor 2018, duhet të zbatojnë kërkesat e Direktivës (EU) 2016/802 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta, dhe të Vendimit të Komisionit (EU) 2015/253 të datës 16 shkurt 2015 që përcakton rregullat lidhur me marrjen e mostrave për analize dhe raportimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor;**

Në funksion dhe në përmbushje të këtyre detyrimeve që përcakton “Traktati për krijimin e Komunitetit të Energjisë”, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, si struktura përgjegjëse ndërshtetërore e Palëve Kontraktuese dhe e BE-së, e ngarkuar për të ndjekur implementimin e këtij dokumenti në kuadër të vendeve që janë Palë Kontraktuese, posaçërisht për trajtimin nga ana e çdo Pale Kontraktuese të çështjeve lidhur me implementimin e *“Acquis communautaire mbi mjedisin”*, ka organizuar Task Forcën për Mjedisin, e cila ka përcaktuar edhe detyra konkrete.

Bashkëpunimi i strukturave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe i strukturave të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në kuadër të kësaj Task Force, është konkretizuar me ngritjen e një Grupi Pune ndërinstitucional, nëpërmjet Urdhërit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.409 datë 26.04.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e projektvendimit që transponzon kërkesat e Direktivës (EU) 2016/802“.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Emetimet nga transporti detar dhe industria për shkak të djegies së lëndëve djegëse të lëngëta me përmbajtje të lartë të squfurit kontribuojnë në ndotjen e

ajrit në formën e dioksidit të squfurit dhe lëndës së grimcuar, të cilat dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin dhe kontribuojnë në depozitim të acidit. 'Shiu acid' dhe dioksidi i squfurit atmosferik dëmtojnë ekosistemet e ndjeshme, zvogëlojnë biodiversitetin dhe dëmtojnë ndjeshëm prodhimin e kulturave dhe rritjen e pyjeve. Acidifikimi është një fenomen ndërkufitar, që kërkon zgjidhje kombëtare ose lokale;

Ndotja nga dioksidi i squfurit mund të ketë gjithashtu një efekt të rëndësishëm në shëndetin e njeriut, veçanërisht në ato grupe të popullsisë që vuajnë nga sëmundjet respiratore.

Aktualisht cilësia e lëndëve djegëse të lëngëta sa lidhet me përmbajtjen e squfurit në to, është rregulluar nëpërmjet Vendimit nr. 781, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëshme, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, i cili **transponon pjesërisht Direktivën 1999/32/EC** të Këshillit të datës 26 prill 1999 “Mbi zvogëlimin në përmbajtje të squfurit tek disa lëndë djegëse të lëngshme”.

Që nga koha e hyrjes në fuqi të “Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë”, në legjislacionin bazë Europian për lëndët djegëse kanë ndodhur ndryshime e përmirësime, dhe konkretisht **Direktiva 1999/32/EC** e Këshillit të datës 26 prill 1999 “Mbi zvogëlimin në përmbajtje të squfurit tek disa lëndë djegëse të lëngshme”, mbas 5 amendimeve përkatësisht nga Rregullorja (EU) Nr 1882/2003; Direktiva 2005/33/EC; Rregullorja (EU) Nr 219/2009; Direktiva 2009/30/EC dhe Direktiva 2012/33/EU **është shfuqizuar nga Direktiva (EU) 2016/802** e Parlamentit dhe Këshillit Evropian në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta.

Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë, të datës 15 qershor 2016, nëpërmjet Vendimit d/2016/15/MC-EnC, u vendos që Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë të **transpozojnë dhe zbatojnë Direktivën (EU) 2016/802** të Parlamentit dhe Këshillit Evropian në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta, **brenda datës 30 qershor 2018**, në përputhje me parashikimet e neneve (1, 2, 3, 4, 5, dhe 6) të këtij Vendimi, që përshtasin nenet e Direktivës (EU) 2016/802 që duhen transpozuar nga vendet që janë Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.

Relation shpjegues për projektvendimin “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor”

Për sa më sipër, për të reflektuar të gjitha ndryshimet/shfuqizimin e Direktivës 1999/32/EC, projektvendimi i propozuar që transponon **Direktivën 2016/802/EC**, shfuqizon Vendimin nr. 781, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëshme, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”.

Elementet kyç të direktivës **2016/802/EC** janë:

1. Standarde më të rrepta të përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta detare që përdoren nga anijet në Zonat e Kontrollit të Emetimeve të SOx (SECAs), që janë ujrat e BE-së, (deri në 0.10% në masë në vitin 2015 nga 1.00% në vitin 2010);
Sipas përcaktimeve të Konventës së MARPOL, Zonat e Kontrollit të Emetimeve të SOx, janë *Deti Balltik dhe Deti i Veriut*.
2. Standarde më të rrepta të përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta detare që përdoren nga anijet në ujrat jashtë BE-së, që quhen (outside – SECAs), (deri në 0.50% në masë në vitin 2020 nga 3.50% aktuale;

Vlera prej 0.50% në masë e squfurit në lëndët djegëse detare në vitin 2020, është detyrim edhe nga Aneksi VI i MARPOL për në zonat ekskluzive ekonomike ose zonat jashtë BE-së;

3. Përdorimi i metodave ekuivalente për arritjen e standardeve të shkarkimeve në ajër të SOx nga impiantet industriale dhe anijet (p.sh. sistemet e pastrimit të gazeve, karburantet alternative, furnizimi me energji elektrike i anijeve në breg etj.)
4. Klauzola që sigurojnë disponueshmërinë e lëndëve djegëse të lëngëta në treg në përputhje me standartet e përcaktuara në direktivë.

Bazuar në kërkesat e Direktivës, projektvendimi krijon sistemin rregullator që siguron:

1. Lëndët djegëse të lëngëta të rënda (**heavy fuel oil**) për qëllime përdorimi **termik, civil e industrial, nuk përdoren me përmbajtje të squfurit më të madhe se 1%**;
2. Lëndët djegëse të lëngëta të mesme të rënda (**gas oil**) për qëllime përdorimi **termik, civil e industrial, nuk përdoren me përmbajtje të squfurit më të madhe se 0,1%**;

3. Lëndët djegëse të lëngëta detare (**marine fuel**) për qëllime përdorimi të transportit ujqor, zbatojnë limitet si më poshtë:

3.1 Në ujërat territoriale të Shqipërisë, në zonat ekskluzive ekonomike dhe në zonat e kontrollit të ndotjes që bien brenda zonave të kontrollit të emëtimeve të SO₂, anijet nuk duhet të përdorin lëndë djegëse detare me përmbajtje squfuri që tejkalon 0.1% në masë;

3.2 Në ujërat territoriale të Shqipërisë, në zonat ekskluzive ekonomike dhe në zonat e kontrollit të ndotjes që bien jashtë zonave të kontrollit të emëtimeve të SO₂:

- 0,10% për **anijet që ankorohen në portet e Shqipërisë** (jo, nëse qëndron më pak se 2 orë në port)
- 1,00% për të gjitha anijet **pas datës 31 Dhjetor 2019**; (0.5% në masë **pas datës 31 Dhjetor 2020**)

Kontrolli i cilësisë së lëndës djegëse të lëngëta, lidhur me përmbajtjen e sqfurit në to, në vendin tonë ka filluar që në janar të vitit 2013, në zbatim të VKM 781/2012, sipas të cilës që prej datës 31 dhjetor 2014 përmbajtja e sqfurit nuk duhet të kalojë 1% nw masw. Bazuar në të dhënat e vitit 2018, në vend është lejuar vetëm tregtimi i lëndëve djegëse të lëngëta të rënda me përmbajtje të sqfurit më të vogël ose të barabartë me 1%. Nga të dhënat e importit rezulton se gjatë vitit 2018 janë importuar rreth 1500 ton mazut me përmbajtje të sqfurit nën 1%, i përdorur për konsum rezidencial dhe industrinë ushqimore. Aktualisht ka një trend të zëvendësimit të lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (mazut) me gaz të lëngët dhe shembujt më të mirë janë përdorimi i tyre nga industria që funksionon në ish-kombinatit metalurgjik-Elbasan, fabrikat e birres etj. Sa i takon lëndëve djegëse të përdorur për djegie në impiantet e rafinerisë së naftës, edhe kur përmbajtja e sqfurit tejkalohe, reduktimi i shkarkimeve të SO₂ në oxhak monitorohet nga Inspektorati përgjegjës i mjedisit, në përputhje me kushtet e specifike të lejes mjedisore për vlerat e lejuara të shkarkimeve të SO₂ në ajër nga impiantit industrial.

Pra, aktualisht në vend tregëtohen vetëm lëndë djegëse të lëngëta të rënda (heavy fuel oil) me përmbajtje të sqfurit deri në 1%, pra objektivat e përcaktuar në VKM 781/2012 janë arritur.

Bazuar në situatën aktuale të përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta si dhe në detyrimet kryesore të Direktivës 2016/802/EC, projektvendimi i propozuar **paraqet disa përparësi:**

1. Autoriteti kompetent, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) për qëllime të kontrollit të përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta, është ngritur në kuadër të zbatimit të VKM 781/2012;
2. Sistemi dhe procedura për monitorimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta të rënda, të lëngëta të mesme dhe të lëngëta detare është ngritur në kuadër të zbatimit të VKM 781/2012; Kjo përfshin laboratorët, pajisjet për marrjen dhe analizimin e mostrave të lëndëve djegëse;
3. Meqenëse nga monitorimi i përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta të rënda, rezulton se përmbajtja aktuale e squfurit është 1% në masë, nisur nga kjo eksperiencë positive, gjatë hartimit të projektvendimit nga grupi i punës u vlerësua që parashikimet tranzitore (nga 1.5% deri në 3.5%) të direktivës lidhur me përmbajtjen e squfurit për lëndën djegëse të lëngët të rëndë (*heavy fuel oil*) të zëvendësohet me vlerën 1% në masë.
4. Rafineritë e naftës dhe impiantet me djegie të pajisuara me leje mjedisi, që përdorin lëndë djegëse të lëngëta të rënda (**heavy fuel**) me përmbajtje të squfurit më të madhe se 1% në masë, janë të ndërgjegjshuara për masat që duhet të marrin për respektimin e vlerave limite të shkarkimeve të SO₂ në ajër, në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit;

Efektet e pritshme:

1. Kontribuon në uljen e shkarkimeve të SO₂ në ajër që vijnë nga transporti detar dhe aktivitetet industriale, duke përmirësuar cilësinë e ajrit në nivel lokal, rajonal dhe global nëpërmjet vendosjes së standarteve për lëndët djegëse të lëngëta dhe monitorimin e tyre;
2. Efektet që ai pritët të ketë janë në aktivitetin e përpunimit dhe tregtimit të lëndëve djegëse të lëngshme për përdorim termik civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor.
3. Studimet në vendet e BE-së kanë treguar se përfitimet nga zvogëlimi i emetimeve të squfurit në ajër, me zvogëlimin e përmbajtjes së squfurit të lëndëve djegëse janë më të mëdha se kostot e parashikuara për industrinë në këtë Direktivë. Teknologjia për zvogëlimin e nivelit të squfurit të lëndëve djegëse të lëngëta dhe është funksionale.
- 4.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor”

Për këtë arsye nga ana e strukturave përkatëse të MIE dhe MTM do të organizohet një takim pune me pjesëmarrjen e faktorëve të interesit për të diskutuar rreth objektit dhe përmbajtjes së këtij projektvendimi, përpara se praktika për këtë projektvendim të përcillet për marrje mendimi në ministritë e tjera.

Problematikat e identifikuara:

1. Mungesa e kapaciteteve teknike për kontrollin dhe monitorimin e lëndëve djegëse të lëngëta detare në bordin e anijeve;
2. Nevoja për trajnime të stafit egzistues të ISHTI lidhur me marrjen e mostrave, kontrollin e anijeve dhe raportimin e të dhënave;
3. Nevojat financiare për të adresuar kostot operacionale të ISHTI, që përfshijnë blerjen e pajisjeve për marrjen e mostrave në anije dhe kostot shtesw tw laboratorit për shkak të rritjes së numrit të mostrave që do të analizohen;
4. Struktura institucionale për monitorimin dhe inspektimin e zbatimit të kërkesave të këtij projektvendimi do të përfshijë edhe autoritetet përgjegjëse detare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës b, të nenit 14, të Ligjit nr.162 datë 04.12.2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

Ky projektvendim i jep fuqi zbatimit të kërkesave të neneve 5, 12 e 16 e të pikave 2 e 3 të shtojcës II të ligjit nr. 9501, datë 3.4.2006 “Për ratifikimin e traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë”, si edhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë d/2016/15/MC-EnC “Mbi zbatimin e Direktives (EU) 2016/802 në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta”.

Gjithashtu, në kuadër të Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet, të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr.9594, datë 27.07.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor”

Ndërkombëtare Detare “Për Parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973 të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (Marpol 73/78)” (**MARPOL**), vendi ynë është në process të ratifikimit të aneksit VI të protokollit që lidhet me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse detare.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi i propozuar transponon plotësisht **plotësisht Direktivën (EU) 2016/802** të Parlamentit dhe Këshillit Evropian në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta, në përputhje edhe me nenet (2, 3, 4, 5, dhe 6) të Vendimit të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë d/2016/15/MC-EnC, i cili ka përshtatur nenet e Direktivës (EU) 2016/802 që duhet të transpozohen nga vendet që janë Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKVENDIMIT

Projektvendimi përmban 4 Krerë, 16 Nene dhe 4 shtojca. Përmbajtja e tyre është si vijon:

Kreu I-rë përmban dispozita të përgjithshme që kanë të bëjnë me qullimin, fushën e veprimit, si edhe Përkufizimin e termave;

Kreu i II-të përcakton përmbajtjen maksimale të squfurit në lëndët djegëse të lëngëta të rënda (**heavy fuel oil**) përpara vendosjes së tyre në treg, **për përdorim termik, civil dhe industrial**. Këto lëndë djegëse tregtohen vetëm nëse plotësojnë kërkesat e standardit shqiptar SSH EN 589 :2008 +A1, SSH EN ISO 9162:2013 dhe SSH UNI 6579 ose të standardeve të tjera, të barasvlershme me to.

Përmbajtja e squfurit, në lëndët djegëse të lëngëta të rënda (mazut), **nuk duhet të kalojë 1,00%** në masë. Ky parashikim **nuk zbatohet**:

1. **Deri në datë 31 dhjetor 2027**, për impiantet e mëdha me djegie dhe rafineritë e naftës që janë pajisur me leje mjedisi sipas ligjit nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit” (ky ligj ka transpozuar Direktivën 2001/80/EC të impianteve të mëdha me diegie):

Relation shpjegues për projektvendimin “Për cilesinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor”

- që respektojnë vlerat limite për shkarkimet e gazeve të SO₂, në përputhje me kushtet e lejes së mjedisit;
- që janë subjekt i planeve kombetare të reduktimit të shkarkimeve në ajër, për të cilët mesatarja mujore e shkarkimeve të dioksidit të squfurit nuk e kalon vlerën 1700 mg/Nm³, për një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara prej 3%, në kushte të thata;

2. **Duke filluar nga data 1 janar 2028**, për impiantet me diegie dhe rafineritë e naftës të cilët pajisen me leje mjedisi në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit (që parashikohet të transpozojë direktivën e re të shkarkimeve industriale 2010/75/EC, e cila zëvendëson direktivën 2001/80/EC), që respektojnë vlerat limite për shkarkimet e gazeve të SO₂ të specifikuara në lejen e mjedisit.

Kreu i III-të përcakton përmbajtjen maksimale të squfurit në lëndët djegëse të lëngëta të mesme, të rënda (gas oil) si lëndë djegëse **për përdorim termik, civil dhe industrial** që plotëson kërkesat e standardit shqiptar SSH EN 589, SSH EN ISO 9162 dhe SSH UNI 6579, ose të standardeve të tjera, të barasvlershme me të. **Përmbajtja e squfurit**, në lëndët djegëse të lëngëta të mesme, të rënda (gas oil), **pas datës 31 dhjetor 2019 nuk duhet të kalojë 0,10% ndaj mases**

KREU IV-ët përcakton përmbajtjen maksimale të squfurit në lëndët djegëse të lëngëta detare, **që përdoret në mjete të transportit detar** që lundrojnë në ujërat territoriale të Shqipërisë, në zonat ekskluzive ekonomike dhe në zonat e kontrollit të ndotjes

Parashikimet kyce të këtij kreu janë:

- Ndalohet përdorimi i lëndëve djegëse të lëngëta detare (**marine fuel**) nëse përmbajtja e squfurit tejkalon vlerën 1 % në masë, me përjashtim të rastit kur anijet përdorin metoda të uljes së përmbajtjes së squfurit, duke operuar me metodën e mbyllur
- Lëndët djegëse të lëngëta detare (**marine fuel**), nuk përdoren *në ujërat territoriale të Shqipërisë, në zonat ekskluzive ekonomike dhe në zonat e kontrollit të ndotjes*, nëse përmbajtja në masë e squfurit në këto lëndë djegëse tejkalohe me:
 - a. 1% në masë **pas datës 31 Dhjetor 2019**; (*Direktiva e ka 3.5% në masë*)
 - b. 0.5% në masë **pas datës 31 Dhjetor 2020**;
- **Deri në datën 1 janar 2020, anijet e pasagjerëve** që lundrojnë në linja të rregullta për ose nga ndonjë port i Shqipërisë, nuk lejohen të përdorin lëndë

djegëse të lëngëta detare (**marine fuel**), në ujërat territoriale të Shqipërisë, në zonat ekskluzive ekonomike dhe në zonat e kontrollit të ndotjes që bien jashtë zonave të kontrollit të emëttimeve të SO₂, nëse përmbajtja e squfurit në to tejkalon 1% në masë. (Direktiva e ka 1.5% në masë).

- **12 muaj mbas datës së përcaktimit të zonave të reja detare nga IMO**, përfshirë portet si edhe zonat e kontrollit të shkarkimeve të SO₂, në ujërat territoriale të Shqipërisë, në zonat ekskluzive ekonomike dhe në zonat e kontrollit të ndotjes që bien brenda zonave të kontrollit të emëttimeve të SO₂, nuk lejohet përdorimi i lëndëve djegëse të lëngëta detare (marine fuel) nëse përmbajtja në masë e squfurit në to tejkalohet me 0.1% në masë
- **Deri në datën 31 dhjetor 2019**, në territorin e Republikës së Shqipërisë, lejohet vetëm tregtimi i lëndëve djegëse të lëngëta detare **diezel, (marine diesel oil), përmbajtja** e squfurit në të cilat, nuk tejkalon **1%** në masë. (Direktiva e ka 1.5% në masë).

Kreu I V-të përcakton përmbajtjen maksimale e squfurit në lëndët djegëse të lëngëta detare që përdoret **në mjete të transportit detar që ankorohen në portet e Shqipërisë**. Parashikimet kyce të këtij kreu janë:

- **Anijet që ankorohen në portet e Shqipërisë** nuk duhet të përdorin lëndë djegëse detare me përmbajtje squfuri që tejkalon 0.1% në masë.
- Në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas datës **31 dhjetor 2020** lejohet vetëm tregtimi i lëndëve djegëse të lëngëta detare, (**marine gas oil**), përmbajtja e squfurit, në të cilat, nuk tejkalon **0.1%** në masë.

Kreu I VI-të përcakton metodat e reduktimit të shkarkimeve në ajër në bordin e anijeve. Të gjitha anijet, pavarësisht nga flamuri që përfaqësojnë, përdorin metoda për të reduktuar shkarkimet e substancave ndotëse në ajër, si alternativë e përdorimit të lëndëve djegëse të lëngëta detare të cilat janë ekuivalente me reduktimin që do të ndodhte nëse do të përdorej lëndë djegëse detare që plotëson standartet e përcaktuara në këtë projektvendim.

Kreu i VII-të përcakton masat që merren si rezultat i një ndryshim të papritur, në furnizimin e vendit me naftë të papërpunuar, produkte të naftës dhe hidrokarbure të tjera (ndërpreje e tregut), gjë që vështirëson aplikimin e kufizimeve për përmbajtjen maksimale të squfurit.

Kreu i VIII-të përcakton **masat dhe autoritetet për kontrollin e cilësisë së lëndës djegëse dhe raportimin**. Ngarkohen Ministri i Infrastrukturës dhe

Energjisë, Ministri i Turizimit dhe Mjedisit, si dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë, të përgatisin dhe miratojnë Udhëzimin e përbashkët për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e të dhënave, për cilësinë e **gazit të lëngët të naftes (GLN)**, lëndëve djegëse të lëngëta të mesme-rënda (**gas oil**), lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (**heavy fuel oil**), lëndëve djegëse të lëngëta detare (**marine fuel**) dhe furnizuesit e këtyre lëndëve djegëse të lëngëta.

Kreu i IX-të parashikon sanksione kundrejt subjekteve, që tregtojnë lëndë djegëse të lëngëta, me cilësi, që nuk respektojnë kërkesat e këtij projektvendimi

Kreu i X-të, parashikon dispozita përfundimtare që shfuqizon Vendimin nr. 781, date 14.11.2012, i Këshillit të Ministarve, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëshme, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”.

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizimit dhe Mjedisit, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të tij janë edhe 6 shtojcat, përkatësisht:

Shtojca 1: Treguesit e lejuar mjedisor për lëndët djegëse (vajguri-gazoil) për përdorim termik, civil dhe industrial

Shtojca 2: Treguesit e lejuar mjedisor për lëndët djegëse (distilate të rënda nga nafta) për përdorim civil teknik dhe industrial

Shtojca 3: Treguesit mjedisorë për lëndët djegëse detare (marine fuel)

Shtojca 4: Treguesit e cilësisë për gazin e lëngëzuar që përdoret për automjete dhe qëllime rezidenciale

Shtojca 5: Metoda e përcaktimit të vlerës ekuivalente të shkarkimeve në atmosferë

Shtojca 6: Kriteret për përzgjedhjen e metodave të reduktimit të shkarkimeve të squfurit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E RREGULLORES

Për zbatimin e projektvendimit “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëshme, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor”, ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizimit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-VENDIMIT

Projektvendimi është hartuar nga Grupi i Punës së ngritur nëpërmjet Urdhërit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 409 datë 26.04.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e projektvendimit që transponon kërkesat e Direktivës (EU) 2016/802”. Grupi i Punës ka në përbërjen e tij përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe nga drejtorite teknike të ministrisë që mbulojnë sektorin e transportit detar dhe të hidrokarbureve.

Për procedim të mëtejshëm do të vijohet me konsultimin publik me grupet e interesit, ku përfshihen kompanitë e prodhimit të hidrokarbureve në vend, kompanitë që importojnë hidrokarbure, shoqatat mjedisore etj, si edhe marrjen e mendimeve nga ministrinë e linjës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Referuar udhëzuesit të BE-së për zbatimin e legjislacionit mjedisor “Handbook on the Implementation of EU Environmental Legislation (2016)”, kostot për zbatimin e Direktivës së sqfurit 2016/802/EC përfshijnë:

Kostot fillestare:

- krijimi i autoriteteve kompetente;
- sistemi i pajisjeve dhe procedurave;
- trajnime mbi procedurat e monitorimit në vecanti metodat ISO 8754 (2003) ose PrEN ISO 14596 (2007)
- përgatitja e udhwzuesve teknikë

Shpenzime kapitale:

- Analizues i sqfurit (afwrsisht EUR 30,000 to 50,000).

Kostot operacionale:

- pajisjet për marrjen e mostrave të lëndëve djegëse (kitet) (afërsisht EUR 150);
- kostot e laboratorit për kryerjen e analizave dhe raportimin e tyre;

- kostot e mirëmbajtjes së analizuesit;

Sipas këtij Udhëzuesi, një kosto indikative për kryerjen e analizës për një mostër në një laborator në vendet e BE-së, **është afërsisht EUR 150**.

Zbatimi i këtij projektvendimi kërkon që institucionet përkatëse të monitorimit (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), të sigurojnë bazën e nevojshme materiale dhe të rrisin kapacitetet e tyre njerëzore, në funksion të monitorimit të sqfurit në lëndët djegëse të lëngëta me teknikat referencë të monitorimit dhe impenjimit financiar për sigurimin e tyre.

Referuar Udhëzimit më lart, sa lidhet me **kostot fillestare dhe shpenzimet kapitale**, në zbatim të Vendimit nr. 781, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëshme, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”:

1. Si **autoriteti kompetent** funksionon Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) për qëllime të kontrollit të përmbajtjes së sqfurit në lëndët djegëse të lëngëta;
2. **Sistemi i pajisjeve dhe procedurave** për analizimin e sqfurit është i ngritur. Laboratori është i pajisur me **analizues të sqfurit**. Deri tani janë kryer analiza vetëm për lëndët djegëse që përdoren për qëllime civile, termike dhe industrial. Me të njëjtin analizues do të kryhen edhe analizat për lëndët djegëse të lëngëta detare.
3. Lidhur me **trajnimet dhe** përgatitjen e **udhwzuesve teknikë**, në kuadër të bashkëpunimit me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, do të organizohen trajnime për rritjen e kapaciteteve të ISHTI-it, dhe do të mbwshtetemi pwr pwrngatitjen e udhwzuwsve teknikw nga Agjencia Evropiane e Sigurisë Detare (European Maritime Safety Agency);

Lidhur me **kostot operacionale**

1. Në rastin e përdorimit të kit-testeve për marrjen e mostrave të lëndëve djegëse dhe analizimin e tyre, vlera e një kiti shkon afërsisht 18,465.00 lekë;
2. Kur mostrat analizohen në laborator, kostoja e analizës së përmbajtjes së sqfurit, sipas të dhënave të marra nga ISHTI, shkon në 40 Euro ose 4,924.00 lekë/ për një mostër lëndë djegëse të lëngët. Sikurse kemi përmendur më lart, deri tani laboratori ka kryer analizimin e lwndeve djegëse që përdoren për qëllime termike civil dhe industrial. Në zbatim të

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor”

këtij projektvendimi, kostot shtesë do të lidhen me analizimin e *lëndëve djegëse detare*, që nuk janë kryer ndonjëherë nga ISHTI.

Sipas projektvendimit numri minimal i inspektimeve për kontrollin e cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta detare për përmbajtjen e squfurit, do të jetë 10 % e numrit total të anijeve që lundrojnë në/nga portet shqiptare të hapura për trafikun ndërkombëtar në tre vitet e fundit; Nga këto marrja e mostrave do të kryhet për vetëm 20% të tyre. Nga të dhënat statistikore lidhur me trafikun e anijeve në/nga portet shqiptare, rezulton se në tre vitet e fundit ne territorin shqiptar kanë lundruar, përkatësisht:

- Viti 2016 578 anije
- Viti 2017 623 anije
- Viti 2018 668 anije

Mesatarisht rreth 626 anije në vit. Numri minimal i inspektimeve është 10% e numrit total të anijeve, pra 62 inspektime. Për 62 inspektime të kryera, vetëm për 20% të tyre do të merren mostra për analizim, pra rreth 12 mostra në vit. Kostoja totale vjetore për analizën e 12 mostrave është 480 Euro në vit ose afërsisht 59,088.00 lekë.

Nëse do të merrnim si referencë, koston indicative të BE-së, prej 150 Euro për kryerjen e analizës për një mostër në një nga vendet e BE-së, ku përfshihen edhe kostot administrative dhe të mirëmbajtjes, kostoja totale do të ishte 1800 Euro ose 221,580.00 lekë.

3. Kostot e mirëmbajtjes së analizuesit të squfurit është e përfshirë në tabelën më poshtë, si pjesë përbërëse e kostove të mirëmbajtjes së të gjitha pajisjeve të laboratorit;

Në tabelën më poshtë, jepen shpenzimet laboratorike të ISHTI-t për vitin 2018. Kostoja totale vjetore ka qenë 143 256 309 lekë për analizimin e 34 treguesve të lëndës djegëse të lëngët, përfshirë këtu edhe squfurin.

	Lloji i shpenzimeve tw analizave laboratorike	Kostot (lekë)
1	Energji+ujë	1 708 887
2	Amortizim pajisjesh, godinë	17 467 059
3	Antidotë për personelin	565 752
4	Veshje për personelin e laboratorit	34 800
5	Etalonët e kalibrimit+reagent kimik	10 981 620
6	Pjesë këmbimi, aksesori, bombola helium, hidrogjeni, azoti etj	3 378 768

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor”

7	Akreditim+standarte	86 270
8	Paga+sigurime shoqërore	110 546 754
	Total	143 256 309

Këtyre shpenzimeve do tu shtohet edhe kostoja afërsisht prej 59,088.00 lekë e kryerjes së analizave për lëndët djegëse detare.

MINISTRI

Belinda BALLUKU